

POLITIKA E PRIVATËSISË

SI I PËRDORIM TË DHËNAT TUAJA PERSONALE

Kontrolluesi i të dhënave – “Banka Credins Kosovë” Sh.a., me seli në Rr. “UÇK”, Nr. 240, Prishtinë, Kosovë, me numër unik identifikimi 811410315.

Banka Credins Kosovë përpunon të dhënat personale të mbledhura për vizitorët e faqes sonë, klientët, kandidatët për punë dhe punonjësit tanë, si dhe individë të tjerë që paraqesin kërkesa të ndryshme për informacion, këshillim, aplikime, etj.

Përdoruesi kërkohet nga faqja e internetit e Bankës Credins Kosovë, www.bankacredins-ks.com, të plotësojë disa të dhëna personale në disa seksione si aplikimet për punë, “Karriera”, “Na Kontaktoni”, “Sugjerime dhe Ankesa”, si dhe aplikimet online për produkte bankare.

Banka Credins Kosovë garanton një sistem sigurie të lartë për ruajtjen dhe përpunimin e mëtejshëm të të dhënave, në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 06/L-082 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të Bashkimit Evropian (GDPR), ne vazhdojmë të mbrojmë dhe të përdorim të dhënat e juaja personale me një nivel shtesë të sigurisë dhe rregulla strikte të privatësisë, së bashku me një procedurë shumë transparente të përpunimit të të dhënave. Përdoruesi konfirmon se informacioni i dhënë është i plotë dhe i saktë dhe deklaron se ka plotësuar në mënyrë korrekte dhe të vërtetë të gjitha të dhënat e kërkuara.

Gjithashtu, gjatë plotësimit online, përdoruesi deklaron se jep pëlqimin e tij/saj për kontrolluesin Bankën Credins Kosovë dhe personat e autorizuar prej saj për përpunimin e mëtejshëm të informacionit të dhënë.

Kjo faqe përcakton mënyrat e administrimit të informacionit dhe të dhënave personale të përdoruesve që e vizitojnë atë. Në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, informacioni vihet në dispozicion të individëve që përdorin shërbimet e bankës përmes internetit, në faqen zyrtare të saj.

Të dhënat jepen vetëm për këtë faqe dhe jo për faqe të tjera që përdoruesi mund të vizitojë përmes lidhjeve të tjera. Pala përgjegjëse për përpunimin e të dhënave personale është “Banka Credins Kosovë” Sh.a., me seli në Rr. “UÇK”, Nr. 240, Prishtinë, Kosovë.

PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Përpunimi i të dhënave personale nënkupton çdo veprim ose grup veprimesh që kryhen mbi të dhënat personale, me ose pa mjete automatike, si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, përdorimi, zbulimi përmes transmetimit, shpërndarja ose vënia në dispozicion në mënyra të tjera, përafrimi ose kombinimi, bllokimi, fshirja ose shkatërrimi i tyre.

Përpunimi i të dhënave personale që lidhen me shërbimet e ofruara përmes internetit nga kjo faqe menaxhohet nga stafi teknik i zyrës përgjegjëse për përpunimin e të dhënave. Asnjë informacion që rrjedh nga shërbimi i ofruar përmes internetit nuk komunikohet apo zbulohet, përveç rasteve

kur informacioni kërkohet nga autoritetet kompetente që e fitojnë këtë të drejtë me ligj të posaçëm, në përputhje me kërkesat ligjore.

- Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen detaje personale dhe informata kontaktuese (p.sh. emri, adresa, data dhe vendi i lindjes, kombësia, etj.)
- informata të identifikimit dhe dokumentit (të tilla si mostra e nënshkrimit, informata të ID).
- të dhëna socio-demografike dhe të dhëna të punësimit
- informata mbi kanalet e përzgjedhura të komunikimit me bankën, përfshirë marketingun
- të dhëna rreth marrëdhënieve të biznesit në lidhje me ju si një klient i Bankës Credins Kosovë.

Të dhënat personale të ofruara nga përdoruesit përdoren vetëm për qëllimin e ofrimit të shërbimit ose për përmbushjen e kërkesës dhe u komunikohen ofruesve të shërbimit, “përpunuesve”, “nën-përpunuesve” dhe palëve të treta vetëm nëse është e nevojshme për këtë qëllim, duke respektuar kërkesat ligjore.

Punonjësit e Bankës janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e informacionit që u jepet për ushtrimin e funksioneve të tyre në përputhje me ligjin dhe mund ta zbulojnë atë vetëm për autoritetet ligjore në bazë të kërkesës së tyre. Banka vlerëson integritetin e tyre para punësimit dhe monitoron përputhshmërinë e tyre me detyrimet për sigurinë e informacionit.

KATEGORITË E SUBJEKTEVE TË TË DHËNAVE QË PËRPUNOHEN

Ne përdorim të dhënat personale të kategorive të subjekteve të të dhënave (klientë, punonjës, kandidatë për punë, etj.) dhe i ruajmë ato për të ofruar shërbim ndaj subjektit të të dhënave, edhe në rastet kur kërkohen për qëllime të tjera të lidhura ngushtë me të.

Të dhënat e kërkimit në faqe dhe procedurat softuerike përgjegjëse për funksionimin e kësaj faqeje marrin të dhëna në kuadër të funksionimit normal dhe vetëm gjatë periudhës së lidhjes, transmetimi i të cilave ndodh gjatë përdorimit të protokolleve të komunikimit në internet.

Kjo faqe nuk përfshin lidhje ndërmjet kësaj faqeje dhe faqeve të tjera. Ju inkurajojmë të lexoni deklaratat e privatësisë në faqet e tjera që vizitoni.

Të dhënat personale për shërbimet e bankimit elektronik ruhen në një sistem me standard të lartë sigurie. Banka përpunon të dhënat personale të përdoruesit dhe personave të autorizuar vetëm për qëllimin e përdorimit të shërbimeve të bankimit elektronik.

Të dhënat mbliidhen jo për të krijuar lidhje me persona të identifikuar, por për shkak të natyrës së tyre mundësojnë identifikimin e përdoruesve përmes përpunimit ose lidhjes me të dhëna dhe informacione të palëve të treta.

Informacioni i dhënë vullnetarisht nga përdoruesi, përfshirë e-mail-et e dërguara në adresat e përcaktuara në këtë faqe, përfshin adresën e dërguesit të nevojshme për t’iu përgjigjur kërkesave si dhe çdo të dhënë tjetër personale të përfshirë në email.

Banka garanton për çdo përdorues se pas dorëzimit të informacionit dhe të dhënave në serverin e faqes së saj, ato ruhen dhe përpunohen më tej në një sistem me standard të lartë sigurie, në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 06/L-082 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Përdorimi i të dhënave personale nga Banka për dërgimin e materialeve reklamuese ose informacionit tregtar për shitjen e produkteve apo shërbimeve kërkon pëlqimin paraprak të subjektit të të dhënave. Duke përdorur aplikacionin, ju jepni pëlqimin tuaj për përpunimin e mëtejshëm të të dhënave. Gjithashtu, nëse nuk dëshironi të informoheni më tej, ju ofrohet mundësia të çregjistroheni përmes një lidhjeje të dedikuar.

Përmbledhje specifike që përgatiten për shërbime të caktuara që mund të kërkohen do të paraqiten ose publikohen gradualisht në faqen e internetit të bankës.

Ne përdorim informacionin e individëve që aplikojnë për punë në Bankë për procesin e aplikimit dhe për monitorimin e statistikave të rekrutimit. Kur duam të ndajmë të dhëna me palë të treta, për shembull për të marrë referenca ose për të siguruar të dhëna nga institucione të tjera relevante, nuk e bëjmë këtë pa informuar paraprakisht subjektet e të dhënave, përveç rasteve kur ky informacion kërkohet me ligj. Të dhënat personale të kandidatëve që nuk përzgjidhen ruhen deri në skadimin e afatit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe më pas shkatërrohen ose fshihen. Ne ruajmë informacion jo të personalizuar për qëllime statistikore për aplikantët, për të ndihmuar aktivitetet tona të rekrutimit, por asnjë aplikant nuk mund të identifikohet nga këto të dhëna.

Ne ruajmë informacionin personal të individëve të punësuar në Bankë vetëm për qëllime punësimi dhe jo përtej tyre. Të dhënat ruhen në vende të sigurta, si në formë fizike ashtu edhe në sisteme kompjuterike, në përputhje me ligjin dhe rregullat tona të brendshme. Kur një punonjës nuk është më pjesë e Bankës, përgatitet një dosje për periudhën gjatë së cilës ai/ajo ka qenë i/e punësuar. Të dhënat e kësaj dosjeje ruhen në mënyrë të sigurt dhe përdoren vetëm për qëllime që lidhen drejtpërdrejt me punësimin, deri në skadimin e afatit të përcaktuar me ligj. Pas kësaj, të dhënat shkatërrohen.

MËNYRAT E PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE PERSONALE

Të dhënat personale të subjekteve përpunohen në mënyrë elektronike dhe manuale, në përputhje të plotë me masat e sigurisë të përcaktuara në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-082 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

AFATI I RUAJTJES SË TË DHËNAVE

Banka Credins Kosovë do t’i ruajë dhe përpunojë të dhënat për aq kohë sa është e nevojshme për të arritur qëllimin për të cilin ato janë mbledhur ose përpunuar më tej.

Të dhënat ruhen sipas afateve të përcaktuara në detyrimet kontraktuale me klientin ose përpunuesit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Pas përfundimit të këtyre afateve, të dhënat shkatërrohen ose anonimizohen.

QASJA NË TË DHËNAT PERSONALE

Banka Credins Kosovë synon të jetë sa më transparente për t'u dhënë individëve qasje në të dhënat e tyre personale. Individët mund të verifikojnë nëse ne mbajmë të dhëna personale për ta duke dërguar një “kërkesë për qasje në të dhënat personale” dhe, në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, banka brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës i informon ata për të dhënat ose shpjegon arsyet pse nuk i ofron ato.

Nëse ne i ruajmë të dhënat tuaja personale, ne do të:

- shpjegojmë pse i ruajmë ato;
- tregojmë marrësin tek i cili janë zbuluar të dhënat;
- informojmë nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare;
- i përshkruajmë ato dhe, nëse është e mundur, do të ofrojmë një kopje të informacionit në një formë të kuptueshme.

Për çdo të dhënë personale që ruhet nga banka, si dhe për çdo të drejtë që ju keni si subjekt i të dhënave në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, është e nevojshme të paraqisni një kërkesë në bankë duke bashkëngjitur edhe dokumentet tuaja ligjore të identifikimit.

TË DREJTAT E SUBJEKTIT TË TË DHËNAVE PERSONALE

Individët, të dhënat personale të të cilëve përpunohen, kanë të drejtë sipas Ligjit Nr. 06/L-082 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të marrin në çdo kohë konfirmim për ekzistencën ose jo të të dhënave personale dhe të njihen me përmbajtjen dhe burimin e tyre, të verifikojnë saktësinë, të kërkojnë përditësimin ose korrigjimin, të drejtën e fshirjes (“e drejta për t’u harruar”), të kërkojnë informacion mbi qëllimin e përpunimit, mbi kategoritë e të dhënave të përpunuara, bllokimin e informacionit dhe të dhënave që përpunohen në kundërshtim me ligjin, si dhe në çdo rast të kundërshtojnë, për arsye legjitime, përpunimin e tyre.

Credins Bank Kosovo ju informon për përpunimin ligjor të të dhënave, si dhe për çdo të drejtë që ju keni si subjekt i të dhënave në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082, datë 30 janar 2019 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Të drejtat e subjektit të të dhënave, të parashikuara në ligjin “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, bazuar në nenin 22 “Kufizimet”, mund të kufizohen nëse një kufizim i tillë respekton thelbin e të drejtave dhe lirive themelore dhe është një masë e nevojshme dhe proporcionale për të garantuar sigurinë publike, parandalimin ose zbulimin e veprave penale, pavarësinë gjyqësore, etj.

SIGURIA E PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE PERSONALE

Banka përpunon të dhënat personale të subjekteve për të zhvilluar aktivitetin e saj dhe për të përmbushur detyrimet ligjore në përputhje me legjisllacionin në fuqi dhe rregullat e brendshme. Kjo mund të përfshijë edhe informacione konfidenciale për kategoritë e subjekteve që përpunohen.

Informacioni është një aset me vlerë, prandaj duhet të ndërmerren masa për ta mbrojtur atë nga përdorimi i paautorizuar, ndryshimi, zbulimi apo shkatërrimi, qoftë aksidental apo i qëllimshëm.

Banka është e përkushtuar të sigurojë përdorimin e sistemeve të informacionit dhe teknologjisë së informacionit në mënyrë që të ruajë integritetin dhe konfidencialitetin e informacionit nën kontrollin e saj. Banka përdor një qasje të bazuar në rrezik për vlerësimin dhe kuptimin e rreziqeve dhe përdor të gjitha mjetet fizike, teknike dhe procedurale për të siguruar masa të përshtatshme sigurie.

Banka merr parasysh zhvillimet teknologjike dhe kostot e zbatimit për të arritur një nivel të përshtatshëm sigurie në përputhje me natyrën e informacionit dhe dëmet që mund të rezultojnë nga një shkelje e mundshme e sigurisë së të dhënave personale.

Të gjithë punonjësit e Bankës janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e informacionit që u është dhënë gjatë ushtrimit të detyrave sipas përkrahjeve të tyre të punës dhe mund ta zbulojnë atë vetëm ndaj autoriteteve ligjore. Banka vlerëson integritetin e tyre para punësimit dhe monitoron përputhshmërinë e tyre me detyrimet për sigurinë e informacionit. Sipas deklaratës së konfidencialitetit të nënshkruar nga punonjësit e bankës, në bazë të së cilës ata mbajnë përgjegjësi civile dhe penale, punonjësit janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e informacionit edhe pas përfundimit të marrëdhënies së tyre të punës.

Duke hyrë në këtë faqe interneti, ju konfirmoni se keni lexuar dhe pranuar kushtet e përdorimit të saj. Ky dokument duhet të kuptohet në përputhje me kushtet dhe termat e bankës dhe përdorimit të kësaj faqeje dhe përbën “Politikën e Privatësisë”, e cila mund të përditësohet në të ardhmen.

Banka Credins Kosovë do të sigurojë respektimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale të klientëve dhe, nëse klientët kanë kundërshtime, banka do të ndërmarrë veprimet e duhura për zgjidhjen e çështjes. Nëse banka nuk ndërmerr masat përkatëse, klienti mund të paraqesë kërkesë pranë Autoritetit për Informim dhe Privatësi në këtë adresë: Rr. Zejnel Salihu - Nr. 22, 10000, Prishtinë - Kosovë, Telefoni +383 38 780 100

SI TË NA KONTAKTONI

Kërkesat për informacion lidhur me politikën tonë të privatësisë mund të dërgohen me e-mail në info@bankacredins-ks.com ose mund të dorëzohen pranë sporteleve të Bankës Credins Kosovë Sh.a.